



Ministria e Financave

RAPORTIMI FINANCIAR DHE KONSOLIDIMI NË KOHËN E COVID-19

Hana Zoričić

Situata përpara COVID-19

- Rritja e PBB-së kroate po përshpejtohej, me normë rritjeje prej 2,9% në 2019.
- Papunësia qe e ulët, në shkallën 6,9% në 2019.
- Në fund të vitit 2019, buxheti i shtetit kishte suficit prej 0,9% të PBB-së.
- Ekonomia e Kroacisë mbështetet fuqimisht në sektorin turistik, i cili zë rreth 25% të PBB-së.



Dy kriza godasin njëkohësisht në tremujorin e parë të vitit 2020

KRIZA NË SHËNDETËSI

- bllokim i pjesshëm i popullatës për shkak të COVID-19

FATKEQËSIA NATYRORE

- Më 22 mars (gjatë bllokimit) një tërmet me magnitudë 5,3 (më i forti i 140 viteve të fundit) ra në Kroaci pranë kryeqytetit Zagreb, duke bërë dëme në ndërtesa dhe duke plagosur me dhjetëra njerëz



Masat e miratuara

- Janë marrë një sërë masash për ta ndihmuar ekonominë për shkak të pandemisë së COVID-19
 - Masat për funksionimin e sistemit të financave publike dhe qëndrueshmërinë e financimit të shërbimeve publike
 - Ndhimja për ruajtjen e vendeve të punës
 - Masat horizontale
 - Masa për të ndihmuar ndërmarrjet shumë të vogla, të vogla dhe të mesme
 - Kredi nga Banka Kroate për Rindërtim dhe Zhvillim (HBOR) dhe nga bankat e nivelit të dytë
 - Ilogari të posaçme për mbledhjen e donacioneve për të ndihmuar në lehtësimin e pasojave të tërmetit që ra në Zagreb (Së Bashku për Zagrebin) dhe të pandemisë së COVID-19 (Kroacia Kundër Koronavirusit)



Masat për funksionimin e sistemit të financave publike dhe qëndrueshmërinë e financimit të shërbimeve publike

- ◆ shtesa dhe ndryshime në Ligjin për Zbatimin e Buxhetit
 - lejojnë huamarrjen shtesë nga qeveria si edhe huamarrjen shtesë nga përdoruesit jashtëbuxhetorë, mbi kufijtë e paracaktuar më parë, me pëlqimin e Qeverisë së Republikës së Kroacisë
 - Lejojnë rishpërndarjen në buxhetin e shtetit përtej asaj që parashikohet në ligjin e buxhetit, me pëlqimin e Qeverisë, nëse ka lidhje me krizën e koronavirusit
 - Shtesa dhe ndryshime në buxheti – 18.5
- ◆ kredi pa interes për pushtetin vendor dhe fondet sociale
 - Duke qenë se të ardhurat e njëjësive të vetëqeverisjes vendore dhe rajonale dhe të fondeve sociale do të bien për shkak të dinamikave të ndryshme të flukseve hyrëse të fondeve dhe për shkak të afateve të shlyerjeve të detyrimeve, Republika e Kroacisë do t'u japë kredi pa interes për ta kapërcyer këtë situatë



Masat për funksionimin e sistemit të financave publike dhe qëndrueshmërinë e financimit të shërbimeve publike

- ◆ Vendim i Qeverisë ku vendosen masat të cilat kufizojnë përdorimin e fondeve nga të gjithat burimet e financimit të planifikuara në Buxhetin e Shtetit për vitin 2020
 - Për shkak të ndryshimeve në zhvillimet ekonomike për shkak të epidemisë së COVID-19 ku është e nevojshme të sigurohen fonde për të financuar masat dhe veprimtaritë kundër epidemisë dhe të ndryshohen aktivitetet e planifikuara buxhetore për të shfrytëzuar sa më mirë potencialin e kufizuar buxhetor
 - Ka qenë e nevojshme të bëhet racionalizim i shpenzimeve publike pa cenuar shërbimet e kujdesit shëndetësor dhe shërbimet sociale
 - Përdoruesit e buxhetit të shtetit mund të marrin vetëm ato detyrime dhe të bëjnë vetëm ato shpenzime të cilat të janë të nevojshme për kryerjen e detyrave dhe funksioneve të tyre bazë
 - Përdoruesve të buxhetit u ndalohet punësimi shtesë



Ndihma për ruajtjen e vendeve të punës dhe masat horizontale

- ◆ **Ndihma për ruajtjen e vendeve të punës**
 - Për të ruajtur vendet e punës në sektorët më të pambrojtur e të cenuar nga koronavirusi, një masë mbështetëse e ndjekur është bashkëfinancimi i kostos së pagave në nivelin 3.250 HRK për punonjës (afro 500 EUR) për muajin mars, ndërsa për muajt prill dhe maj kjo shumë është rritur në 4.000 HRK (afro 550 EUR)
 - Kontributet e sigurimeve për fondin e pensionit dhe për fondin e sigurimeve shëndetësore janë paguar nga buxheti i shtetit
 - Paraqiten si aktivitet i veçantë në buxhetin e shtetit
- ◆ **Masat horizontale**
 - Shtyrja dhe shuarja e detyrimit të pagesave të tatimeve të drejtpërdrejta dhe të kontributeve për bizneset në vështirësi



Masa për të ndihmuar ndërmarrjet shumë të vogla, të vogla dhe të mesme dhe kreditë nga HBOR dhe bankat e nivelit të dytë

- ◆ **Masat për të ndihmuar ndërmarrjet shumë të vogla, të vogla dhe të mesme**
 - Këto masa janë financuar me mbështetjen e fondeve evropiane
- ◆ **Kredi nga Banka Kroate për Rindërtim dhe Zhvillim (HBOR) dhe nga bankat e nivelit të dytë**
 - Një program është financimi i likuiditetit të eksportuesve nëpërmjet një skeme të sigurimit të portofolit
 - Programi i dytë mbështetet në instrumentet me kredi të buta të HBOR-së me subvencionim të interesave nga ana e shtetit
- ◆ **Krahas kësaj, bankat e nivelit të dytë kanë marrë një sërë masash të cilat u japin bizneseve dhe qytetarëve moratorium, riprogramim të shlyerjes së detyrimeve kreditore, por edhe kredi të reja për likuiditetit dhe për kapital qarkullues.**



Pasqyrat financiare – afatet dhe disa sfida

- ◆ Shtyrja e afatit për dorëzimin e pasqyrave financiare vjetore për vitin 2019 për bizneset dhe shtyrja e afateve për konsolidimin
 - 30.4 → 30.6
- ◆ Shtyrja e afatit për dorëzimin e pasqyrave financiare tremujore për përdoruesit buxhetorë në nivel shteti dhe në nivel vendor
 - Në fillim, afati është shtyrë deri në një njoftim të dytë
 - Më pas, afati është caktuar për 11.5
- ◆ Udhëzime të posaçme nga MF se si të regjistrohen të gjitha masat dhe flukset (brenda qeverisjes së përgjithshme) sa i takon COVID-it në regjistrat kontabël

